Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 980-984/20
Datë/Datum 11.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.980/20
984/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina – Kryetar , z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: "Construmax"SH.P.K-Suharekë; N.N.SH "Top Projekt"-Suharekë , dhe grupi i OE: "Ada Consulting Group "SH.P.K,; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues,ku është rekomanduar për kontratë OE: "Euroing"SH.P.K-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë-Bytyqi-Faza e dytë" , me nr. të prok: 224-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Suharekë, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHEN, si pjesërisht të bazuara: ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: "Construmax"SH.P.K-Suharekë dhe ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: "Ada Consulting Group "SH.P.K,; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë, kundër vendimit te Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë-Bytyqi-Faza e dytë" , me nr. të prok: 224-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Suharekë ,

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës , për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë-Bytyqi-Faza e dytë" , me nr. të prok: 224-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Suharekë dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: "Construmax"SH.P.K-Suharekë; N.N.SH "Top Projekt"-Suharekë , dhe grupi i OE: "Ada Consulting Group "SH.P.K,; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë, i aprovohen si të bazuara dhe pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Grupi i operatorëve ekonomik ankues: "Construmax"SH.P.K-Suharekë; N.N.SH "Top Projekt"-Suharekë , dhe grupi i OE: "Ada Consulting Group "SH.P.K,; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë,si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 19.11.2020 me nr. 980/20 , dhe me datë 20.11.2020 me nr. 984/20 , kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë-Bytyqi-Faza e dytë" , me nr. të prok: 224-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Suharekë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 59 , 60 , 67 , 68 , 69 , 72 , si dhe nenin 108/A të LPP-së , te ankesa me nr. 980/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 59 , 60 , 64 , 69 , si dhe nenin 72 të LPP-së , te ankesa me nr. 984/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES : "Construmax"SH.P.K-Suharekë; N.N.SH "Top Projekt"-Suharekë, Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që e plotëson kriterin lidhur me pune e kryera te natyrës se ngjashme ne tre vitet e fundit 3.9 milion euro, ku lideri i grupit duhet te ketë 60% te vlerës. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që lideri

i grupit jo vetëm që e përmbush 60% e kërkuar mirëpo edhe e tejkalon, ku ka ofruar dëshmi të mjaftueshme me vërtetim nga banka në vlerë prej 4,409,392.558 € , me referenca e procesverbale të punimeve të kryera në vlerë 3,662,111.42 €. Disa projekte tjera janë në listën e projekteve si të përfunduara me te dhëna te pranimit final, e që konform nenin 72 AK mund te kërkoj sqarime shtesë. Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt është eliminuar pa arsye lidhur me para kontratën e inxhinierit të elektroteknikes, i cili në CV e tij është prezantuar që ka marrëdhënie pune edhe në KEDS dhe ka kontratë me OE me orar të plotë. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që OE konform kriterit të dosjes së tenderit ku është kërkuar kontratë e punës ose marrëveshje për projektin „para kontrata" ka ofruar Para kontratën me Inxhinieri e elektroteknikes z. Skender Nitaj për këtë projekt. Sikur OE ankues te kishte ofruar kontrate me orar te plote do ishte e bazuar arsye e eliminimit nga AK, ndërsa ne këtë rast OE ankues e ka ofruar para kontratën me z. Skender Nitaj ku vetëm nëse e fiton kontratën do te angazhohet ne ekzekutim ne te ardhmen me orar te plote. Çështja e para kontratave te prezantuara nga OE ankues vlen edhe për inxhinieret tjerë te prezantuar nga OE, e te cilët aktualisht janë ne marrëdhënie pune tjera, por para kontratat kane te bëjnë vetëm me këtë projekt dhe vetëm nëse shpërblehet me kontratën ne fjale do te angazhohen ne implementim te punëve me orar te plote. OE ankues ka prezantuar kontratë standarde për bashkëpunim për projekte të caktuar, si dhe ka bashkangjitur CV, diplomën e noterizuar si dhe një deklaratë të nënshkruar nga vetë inxhinieri i cili ka deklaruar që edhe nëse është i punësuar në ndonjë vend tjetër, është i gatshëm të ndërpres punimet dhe të shërbej në Construmax shpk për këtë projekt. Po ashtu OE ankues ka ofruar edhe dëshmi listën e pagave në ATK dhe fletëpagesën nga banka për pagat Procredit BANK, ku ky inxhinier është si i punësuar nga muaji shtator në Consturmax dhe ju është paguar paga përmes bankës. OE ankues ka paraqit edhe listën e stafit shtesë qe mund te angazhohen për këtë projekt.

Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt se është eliminuar pa arsye lidhur me kontratën e inxhinierit të infrastrukturës i cili në CV e tij është prezantuar që ka marrëdhënie pune edhe me Komunën e Prishtinës dhe ka kontratë me OE me orar të plot. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që OE konform kriterit te dosjes se tenderit ku është kërkuar kontratë e punës ose marrëveshje për projektin „para kontrata'' ka ofruar Para kontratën me Inxhinieri e Infrastrukturës z. Besim Qelaj për këtë projekt. Sikur OE ankues te kishte ofruar kontrate me orar te plote do ishte e bazuar arsyeja e eliminimit nga AK, ndërsa ne këtë rast OE ankues e ka ofruar para kontratën me z. Besim Qelaj ku vetëm nëse e fiton kontratën do te angazhohet ne ekzekutim ne te ardhmen me orar te plote. Çështja e para kontratave te prezantuara nga OE ankues vlen edhe për inxhinieret tjerë te prezantuar nga OE, e te cilët aktualisht janë ne marrëdhënie pune tjera, por para kontratat kane te bëjnë vetëm me këtë projekt dhe vetëm nëse shpërblehet me kontratën ne fjale do te angazhohen ne implementim te punëve me orar te plote. OE ankues ka prezantuar kontratë standarde për bashkëpunim për projekte të caktuar, si dhe ka bashkangjitur CV, diplomën e noterizuar si dhe një deklaratë të nënshkruar nga vetë inxhinieri i cili ka deklaruar që edhe

nëse është i punësuar në ndonjë vend tjetër, është i gatshëm të ndërpres punimet dhe të shërbej në Construmax shpk për këtë projekt. Po ashtu OE me ankese ka ofruar edhe dëshmi listën e pagave në ATK dhe fletëpagesën nga banka për pagat, ku ky inxhinier është si i punësuar nga muaji shtator në Consturmax dhe ju është paguar paga përmes bankës PCB.

Po ashtu OE ankues ka paraqit edhe listën e stafit shtesë qe mund te angazhohen për këtë projekt., dhe sqaron që punimet elektrike janë punime që zhvillohen sipas planit dinamik dhe mund të përcillen edhe nga një inxhinier me punë sekondare. Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt është eliminuar pa arsye, lidhur me eliminimi e këtij OE që i mungon Ekskavatori me tonazh 1.2 deri në 1.7 ton. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që ka ofruar marrëveshje mbi dhënien me qira me Horn & Co. Kosova sh.p.k, të dy mini ekskavatorëve: Mini ekskavator 1.751 ton, Marka Volovo, Tipi EC, nr i shasisë VCE0C18CV00002588 dhe Mini ekskavator 1.860 ton, Marka Kubota, Tipi : KX018-04-SN, nr. i shasisë ËKFRGF1100X05644 Po ashtu ka prezantuar edhe DUD-at doganor dhe katalogun e prodhuesit për këta ekskavator. Eksperti Shqyrtues konstaton që në DUD-in doganor R 11465 I datës 21/08/2015 është pesha e ekskavatorit 1.751 ton dhe e plotëson kërkesën e dosjes së tenderi duke pasur parasysh edhe aksesorët e tij.

Ne ofertën e OE ankues ekziston katalogu – specifikacioni i ekskavatorit te brendit "Kubota" ne te cilin janë te specifikuara ne mënyrë te qartë te gjithë parametrat e ekskavatorit te ofruar.

Si duket AK nuk i ka lexuar drejte parametrat e ekskavatorit, ku janë referuar vetëm ne një parametër 1860 kg, e cila është pesha ne total e ekskavatorit e ku përfshihen edhe shume pjesë "aksesor" rezervë si p.sh: Lugët e disa dimensioneve, shkallet e ngarkimet, pllatot e ngarkimit, zinxhirët etj. Ndërsa pesha reale e vetëm ekskavatorit është 1620kg dhe është Brenda parametrave te kërkuara nga AK ne NJK dhe DT. Pavarësisht nga sqarimet e lartcekura, edhe sikur te qëndronte arsyeja e cekur nga AK, kjo mund te konsiderohej si devijim i vogël bazuar ne Nenin 59 te LPP-së, paragrafi nr. 4 theksohet se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Për dëshmi parametrat e ekskavatorit:

TECHNISCHE DATEN

*Mit Gummiketten

Modell			KX018-4
Gewicht der Maschine*1 (Kabine / Schutzdach)		kg	1720 / 1620
Einsatzgewicht*2 (Kabine / Schutzdach)		kg	1795 / 1695
Löffelkapazität (Standard: SAE/CECE)		m³	0,04
Löffelbreite (Mit / Ohne Seitenschneider)		mm	474 / 450
Motor	Modell		D902-BH
	Typ		Wassergekühlter Dieselmotor E-TVCS
	Ausgangsleistung ISO9249	PS bei U/min	16 / 2300
		kW bei U/min	11,8 / 2300
	Anzahl der Zylinder		3
	Bohrung × Hub	mm	72 × 73,6
	Hubraum	cc	896
Gesamtlänge		mm	3710
Gesamthöhe (Kabine / Schutzdach)		mm	2350 / 2330
Drehgeschwindigkeit		rpm	9,1
Gummikettenbreite		mm	230
Achsabstand		mm	1230
Planierschild-Abmessungen (Breite × Höhe)		mm	990 / 1300 × 230
Hydraulik-pumpen	P1, P2		Axialkolbenverstellpumpe
	Fördermenge	ℓ/min	17,3
	Hydr. Druck	MPa (kg/cm²)	21,6 (220)
	P3		Zahnradpumpe
	Fördermenge	ℓ/min	10,4
	Hydr. Druck	MPa (kg/cm²)	20,6 (210)
Max. Reißkraft am Löffelstiel		daN (kgf)	830 (840)
Max. Ausbrechkraft am Löffelzahn		daN (kgf)	1590 (1620)
Ausleger Schwenkwinkel (Links/Rechts)		Grad°	75 / 60
Zusätzlicher Steuerkreis	Hydraulikölmenge	ℓ/min	27,7
	Hydraulikdruck	MPa (kg/cm²)	21,6 (220)
Hydrauliktankkapazität		ℓ	28
Kraftstofftankkapazität		ℓ	21
Max. Fahrgeschwindigkeit (1.Gang / 2.Gang)		km/h	2,2 / 4,0
Bodendruck (Kabine / Schutzdach)		kPa (kg/cm²)	26,5 (0,27) / 25,5 (0,26)
Bodenfreiheit		mm	160

ARBEITSBEREICH



1.090 mm Löffelstiel
Einheiten in: mm

Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt se është eliminuar pa arsye, lidhur me pozicionin e parë në paramasë si pozicion manipulativ dhe qe nuk mund të arsyetohet me asnjë rregull e as standard inxhinierik. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues nuk e ka sqaruar saktë pse është çmim manipulativ, dhe nuk ka dërguar ndonjë formular për sqarime të çmimit Jo-normalisht të ulët. OE ankues në pozicionin e parë në paramasë ka vendosur çmimin njësi në vlerë prej 217,000.00€ ku përshkrimi ka qenë „Pastrimi i terrenit dhe shenjëzimi i vendit për ndërtimin e objektit", të njëjtin çmim e ka shumëzuar dhe ka mbledhur në rekapitullim. Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt është eliminuar pa arsye lidhur me kontratën e inxhinierit të Arkitekturës e cila ka marrëdhënie pune edhe në Ministri dhe ka kontratë me OE me orar të plotë. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi që OE ka ofruar Kontratë Pune me inxhinieren e Arkitekturës, dhe të njëjtën e ka edhe në lista të pagave, si dhe ka bashkangjitur CV, diplomën e noterizuar, mirëpo eksperti shqyrtues konsideron që janë përdor kritere të dyfishta gjate procesit te vlerësimit, pasi që edhe OE i shpallur fitues në CV e stafit dëshmohet që janë duke punuar në kompani tjera dhe nuk janë eliminuar. Sa i përket inxh. te Arkitekturës, vlen te theksohet znj. Arzie Zeneli figuron ne Listën e punëtoreve ne ATK tek OE ankues dhe ku dëshmohet se znj. Zeneli nuk është e angazhuar si staf primar por sekondar. Vlen të theksohet se lideri i konzerciumit OE Construmax ne kuadër të stafit

profesional për angazhim ne këtë projekt i ka edhe dy inxhinier të arkitekturës z. Nexhat Jashari me përvojë 20 vite dhe znj. Krenare Shkodra me përvojë 7 vite. Andaj kriterin e inxhinierit te arkitekturës mund ta plotësoj edhe vetëm lideri nëse AK e sheh te nevojshme me sqarime shtese bazuar ne nenin 72 te LPP-se, pasi qe e ka të bashkangjitur me ofertë Listën e stafit te inxhiniereve bashkëpunëtor që mund të kyçën në projektin „ Ndërtimi i Shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi- Faza e dytë'' Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE e rekomanduar i cili që nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme për Inxhinierin e Infrastrukturës që ka përvojë 3 vjeçare. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar, pasi që në CV e tij ka dëshmi që ka përvojë 3 vjet si inxhinier i infrastrukturës. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt nr. 9, 10, 11,12 që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE Euroing pasi që nuk ka prezantuar dëshmi që inxhinieret do të punojnë në Euroing për këtë projekt pasi që në CV e tyre ceket që vazhdoj në kompani tjera. Eksperti Shqyrtues konsideron që këto pretendime të OE ankues janë pjesërisht te bazuara, pasi që OE i rekomanduar ka ofruar Kontratë mbi Vepër, CV, Diplomë të Noterizuar dhe Referencë, ndërkohë qe Inxhinieret ne fjale janë ne marrëdhënie pune ne kompani tjera. Kjo është situate e njëjtë me disa nga inxhinieret e prezantuar edhe nga konzerciumi ankues Construmax & Top Projekt, andaj duhet te vleje parimi i njëjtë, ku duhet te pranohen para kontratat për projektin ne fjale qe nëse OE e fiton kontratën ti angazhoj inxhinieret gjate implementimit te punëve. AK duhet ti trajtoj ne mënyrë te barabarte operatoret ekonomik konform nenit 7 te LPP-se dhe për situatën e njëjtë me para kontrata nuk duhet qe një OE ta eliminoj ndërsa një OE ta shpalli fitues. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt, rreth ofertës financiare te OE te rekomanduar dhe që Autoriteti Kontraktues nuk i ka korrigjuar gabimet aritmetike që kalojnë 21% të vlerës së ofertuar. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE i rekomanduar ka vendosur në kolonën e paramasës tek „Çmim njësi (€)'' ka vendosur çmime njësi 40 %, 3.5 %, 3.5%. Nuk ekziston njësi monetare ne përqindje (%), dhe në dosje të tenderit tek Seksioni I. Informacione për tenderuesit, paragrafi 20 specifikon se : 20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit -20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro **(€).** Çmimi i ofertuar lejohet qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës.

Eksperti Shqyrtues konsideron që OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar siç duhet FDT - Formularin e Dorëzimit te Tenderit, që është dokumenti kryesor i ofertës, dhe ku Pjesa II - Përshkrimi i Çmimeve është pjese e FDT-se. Për 3 pozicione të paramasës OE i rekomanduar nuk ka ofruar çmim në Euro siç kërkohet në Dosje te tenderit dhe çmimet e ofruar në përqindje janë të papranueshme. Në bazë RRUOPP-së neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrative, andaj OE i rekomanduar Euroing nuk e ka plotësuar këtë kriter. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE e

rekomanduar pasi që ky OE ka ndërhyrë në paramasë, duke i ndryshuar sasitë e 3 pozicioneve të paramasës së publikuar nga AK.

Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE i rekomanduar Euroing, sasitë e publikuara në e-prokurim i ka ndryshuar në ofertën e dorëzuar: Pozicionet të cilët janë ndryshuar nga OE Euroing janë: Pos A.17 nga sasia e tenderuar 4,960.00 është ndryshuar në 3,070.60- sasia e ofertës financiare Pos A.24 nga sasia e tenderuar 0 është ndryshuar në 38,610.09- sasia e ofertës financiare Pos B.20 nga sasia e tenderuar 0 është ndryshuar në 79,109.00 - sasia e ofertës financiare Në rast që OE ka pasur paqartësi lidhur me sasitë e paramasës se tenderuar ka mundur të kërkoj sqarime shtesë përmes "Aneksi 5 - Kërkesa për informacione shtesë'' , pasi që paramasa është pjese e FDT dhe nuk mund të ndryshohet nga OE. Në bazë RRUOPP neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrative, andaj OE i rekomanduar Euroing nuk e ka plotësuar këtë kriter. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që OE tjetër Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k_që janë të papërgjegjshëm pasi që i mungon qarkullimi me kontrata 60% liderit të grupit Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është pjesërisht i bazuar, pasi që OE Ada Consulting Group e ka prezantuar qarkullimin bankar 17,333,781.48€ dhe ka prezantuar edhe listën e projekteve, ku Autoriteti Kontraktues konform nenin 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë për referencat për punimet e kryera sipas listës së projekteve të prezantuara.

Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që janë të papërgjegjshëm pasi që inxhinieri i Infrastrukturës rrugore i prezantuar nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE Ada Consulting Group ka prezantuar inxhinierin e Infrastrukturës Rrugore që ka diploma në vitin 2015 mirëpo në CV e tij nuk ka dëshmi që ka 3 vite përvojë mbas diplomimit, d.m.th CV nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që janë të papërgjegjshëm për arsye që nuk ka ofruar kamion me kran sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar për arsye që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k, ka dorëzuar me ofertë një marrëveshje për shfrytëzim të pajisjeve me kompaninë A CON sh.p.k dhe ne librezën e Kamionit me Vinç 2 dyer me regjistrim 01-625-MS ku nuk ceket gjatësia e kranit, mirëpo në dy skicat e gjatësisë së kranit PK 66000E gjatësia ma e madhe është 20.4 m' ndërsa tjetra skicë e PJ 115D PK 66000E është 13.6m, ndërsa kërkesa në dosje të tenderit ka qenë mbi 25m. Bazuar në skicat e ofruara ky kamion nuk e plotëson gjetësin e kranit ashtu siç është kërkuar ne DT prej 25m. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që Autoriteti Kontraktues nuk i ka eliminuar OE Ada Consulting Group shpk & Krapi Com sh.p.k pasi që ky OE ka ndërhyrë në paramasë. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE Ada Consulting Group sh.p.k &

Krapi Com sh.p.k sasitë e publikuar në e-prokurim ka ndryshuar në ofertën e dorëzuar: Pozicionet të cilët janë ndryshuar nga OE Euroing janë:

Pos A.17 17 nga sasia e tenderuar 4,960.00 është ndryshuar në 6,934.00- sasia e ofertës financiare

Pos A.24 nga sasia e tenderuar 0 është ndryshuar në 37,387.10- sasia e ofertës financiare

Pos B.20 nga sasia e tenderuar 0 është ndryshuar në 66,920.00- sasia e ofertës financiare

Në rast që OE ka pasur pa qartësi lidhur me sasitë e publikuar ka mundur të kërkoj sqarime shtesë përmes "Aneksi 5 Kërkesa për informacione shtesë" - pasi që paramasa është pjese e FDT dhe nuk mund të ndryshohet nga OE. Në bazë te RRUOPP neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ, andaj OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k nuk e ka plotësuar këtë kriter. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k pasi që ky OE ka gabim aritmetik tek ngrohja qendrore që tejkalon vlerën 2%. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE ka vendosur në kolonën tek „Çmim njësi (€)'' ka vendosur në pozicionin B.20 çmime 3.5%, ku nuk ekzistoni njësi monetare përqindje (%), dhe në dosje të tenderit tek Seksioni I. Informacione për tenderuesit, paragrafi 20: 20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit -20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro **(€).** Çmimi i ofertuar lejohet qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës.

Eksperti Shqyrtues konsideron që OE I rekomanduar nuk e ka plotësuar siç duhet formularin e tenderit që është dokumenti kryesor i ofertës, për 3 pozicione të paramases nuk ka ofruar çmim në Euro siç kërkohet në Dosje të tenderit dhe çmimet e ofruar në përqindje janë të papranueshëm.

Në bazë RRUOPP neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ, andaj OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k nuk e ka plotësuar këtë kriter. Bazuar në dosje të tenderit, Eksperti Shqyrtues konsideron që çmimi njësi është në Euro jo në % dhe shuma kalkuluese e njësive me çmimet e ofertuar tejkalon 2% e gabimit aritmetik të lejuar me LPP-në dhe ky gabim aritmetik është 66,920.00 * 3.5 = 234,220.00 €, ndërsa shuma në ofertë është 2,342.20 € d.m.th. kemi gabim aritmetik mbi 2% krahasuar me totalin e ofertës. Në rast që OE ka pasur pa qartësi lidhur me plotësimin e çmimeve njësi ka mundur të kërkoj sqarime shtesë përmes ,"Aneksi 5 - Kërkesa për informacione shtesë" në dosje të tenderit. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që OE „ISEFERI" nuk i plotëson as kushtet administrative për këtë tender. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE „ISEFERI" nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit d.m.th. nuk e ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit, nuk plotëson qarkullimin e kërkuar, nuk i

ka ofruar referencat e natyrës së ngjashme, nuk e plotëson stafin e kërkuar, nuk ka dëshmi për makineri, andaj konsiderojmë që ky OE nuk i ka plotësuar kriteret e tenderit.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Ada Consulting Group "SH.P.K,; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë, Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113 i LPP-së) të OE ankues: Grup i Operatorëve Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.; Krapi Com SH.P.K., Sa i përket pretendimit OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që lideri i grupit nuk e plotësoni qarkullimi me kontrata 60%. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është pjesërisht i bazuar, pasi që kozorciumi OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k ka dorëzuar listat e projektit të ekzekutuara edhe lideri edhe partneri i konzorciumit, ku në lista vërehen projekte që kalojnë vlerën e kërkuar, mirëpo lideri i grupit nuk ka dorëzuar referenca apo procesverbale të pranimit teknik ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. AK ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga OE bazuar në nenin 72 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group shpk & Krapi Com sh.p.k që arsyeja e dyte që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që Inxhinieri i Infrastrukturës rrugore nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i pabazuar, pasi që kozorciumi i OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k ka dorëzuar diplomën, cv dhe referencat mirëpo as në CV e as në referenca nuk ka dëshmi që ka përvojë 3 vjet pas diplomimit si inxhinier i Infrastrukturës rrugore ashtu siç është kërkuar, mirëpo ka dëshmi që ka përvojë para diplomimit si inxhinier i Ndërtimit d.m.th. CV e prezantuar nuk përmbush kërkesat sipas dosjes së tenderit dhe bazuar në RRUOPP neni 39 tenderi duhet refuzuar kur CV e stafit nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit. Sa i përket pretendimit te OE ankues Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që arsyeja e tretë që është eliminuar padrejtësisht është që kamioni me kran i tipit Volvo FL 108x2 me numër të targave 01-825-MS nuk e ka gjatësinë prej 25m sipas njësisë së kërkesës por është 20.4m. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i pabazuar, pasi që kozorciumi OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k ne ofertë ka dorëzuar marrëveshje për shfrytëzim të pajisjeve me A CON sh.p.k dhe librezën e Kamionit me Vinç 2 dyer me regjistrim 01-625-MS ku nuk ceket gjatësia e kranit, mirëpo në dy skicat e gjatësisë së kranit PK 66000E gjatësia ma e madhe është 20.4 m' ndërsa tjetra skicë e PJ 115D PK 66000E është 13.6m, ndërsa kërkesa në dosje të tenderit ka qenë mbi 25m, andaj bazuar në skicat e ofruar ky kamion nuk e ka kranin me gjatësinë siç është kërkuar mbi 25m. Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat teknike dhe profesionale ku është kërkuar, Kërkesa 8 - Inxhinier ose master i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi i Infrastrukturës rrugore, së paku me 3 vite përvojë pune pas diplomimit" . Inxhinieri i prezantuar në CV e tij nuk përmbush kërkesën e lartcekur sepse i mungon

përvoja 3 vjeçare pas diplomimit si inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë -Infrastrukturës, si dhe i mungojnë referencat. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i pa bazuar pasi që në CV e inxhinierit të infrastrukturës është përvoja e kërkuar prej 3 viteve si inxhinier i Infrastrukturës pas diplomimit dhe bazuar ne CV e ofruar i përmbush kërkesat e FDT-së. Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që OE i rekomanduar në deklaratën nën betim nuk është nënshkruar nga pronari dhe nuk përputhen nënshkrimet e pronarit nga CV dhe kontratat me nënshkrimin e Deklaratës nën Betim. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar pasi që vërehet që nënshkrimi i deklaratës nën betim nuk është i nënshkruar nga pronari pasi që edhe është i shënuar "për" pastaj nënshkrimi i një personi të paautorizuar dhe që nuk ka ndonjë dokument të prezantuar që ka autorizim për nënshkrimin e dokumentacionit dhe në Certifikatën e Biznesit është pronar z. Mefail Gashi dhe nuk ka të autorizuar tjerë. Andaj konsideroj që Deklarata nën betim, lista e stafit Teknik dhe punëtoreve janë të nënshkruar nga një person i paautorizuar dhe nuk përputhet me nënshkrimin e pronarit z. Mefail Gashi, nënshkrim i cili gjendet në CV e tij të nënshkruar. Ne lidhje me këtë çështje ekziston Interpretimi Ligjor nga KRPP-së tek Pyetjet e Shpeshta, Nr. 40, ku theksohet se: Pyetja 40. Si të veprohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar? Përgjigja - Interpretimi i dhënë nga KRPP: Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent , nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.? Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që CV-ja e prezantuar e inxhinierit të Infrastrukturës Defrim Kabashi, ku dyshohet që nënshkrimi i kontratës së këtij inxhinieri nuk përputhet me nënshkrimin e bërë në deklaratën nën betim dhe nuk është nënshkruar nga një person i autorizuar. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, dhe nënshkrimi i dokumenteve te ofertës nga personi i paautorizuar është trajtuar me sipër ne pretendimin paraprak. Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që inxhinieri i Hidroteknikës Qamil Shala i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, që në CV e prezantuar shkruan se nga viti 2010 edhe më tutje vazhdon të punoj të Hidroing DK dhe ka prezantuar një letër referencë nga një

kompani tjetër në të cilën shkruan së ka qenë pjesë e kompanisë Diarko pa specifikuar ndonjë datë se kur ka filluar punën në atë kompani apo është ende në atë kompani, pasi që letër referenca është e paqartë. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është pjesërisht i bazuar, pasi që ka paqartësi lidhur me referencën nga Diarko dhe mos përputhje me CV, andaj AK ka mundur te kërkojë sqarime shtese konform nenit 72 te LPP-së. Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com që nuk është lista e mjeteve te prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, e nënshkruar nga drejtori Mefail Gashi mirëpo nga një person i pa autorizuar. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, dhe nënshkrimi i dokumenteve te ofertës nga personi i paautorizuar është trajtuar me sipër ne pretendimin paraprak. Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com që kamioni i prezantuar nga OE për kontratë me targa 639-KS-229, i cili është me regjistrim të skaduar dhe që nuk plotëson kërkesën në lidhje me mjetet e kërkuara. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i pa bazuar, pasi që validiteti i Regjistrimi te kamionit nuk ka qenë kërkesë e NJK dhe DT. Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.pk. & Krapi Com që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshja për shfrytëzim të mjeteve të cilën e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë është e lidhur me një OE i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të Prokurimit pra me kompaninë ISEFERI sh.p.k, si dhe mos nënshkrimi nga pronari mirëpo nga një person i pa autorizuar. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE ISEFERI është ofertues në këtë tender dhe nuk ka te drejt të jetë pjesë e ndonjë oferte tjetër për të njëjtin tender. Marrëveshja për shfrytëzim të mjeteve është pjese e tenderit, dhe kompania ISEFERI sh.p.k me rastin e lidhjes se marrëveshjes me OE te rekomanduar është bërë pjesë e ofertës se tij. Ne lidhje me këtë çështje merret për bazë interpretimi i dhënë nga KRPP, për rastin e ngjashëm ku parimi ligjor është i njëjtë - Pyetjet e shpeshta, Pyetja nr. 48. Gjithashtu, nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet te prokurimit të ndarë në LOT-e, në njërin LOT konkurron si i vetëm, ndërsa ne një Lot tjetër ne grup, kjo kompani nuk mund te dorëzoj deklaratën qe konfirmon se ai anëtar nuk është duke marre pjese ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit. Bazuar në çka u tha më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore të OE ankues Construmax sh.p.k & N.N.SH TOP Projekt janë të bazuara sepse AK ka rekomanduar për kontratë OE më të shtrenjtë për 248,104.66 € dhe i cili është administrativisht i pa përgjegjshëm për mos plotësim siç duhet të FDT- Përshkrimit te çmimeve. Konzorciumi Construmax sh.p.k& NNSH TOP Projekt, i ka plotësuar të gjitha kriteret e vendosura në dosje të tenderit, arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë, meqenëse ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe që tejkalojnë kërkesat e dosjes së tenderit. Bazuar në çka u tha më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore të OE Ada_Consulting Group sh.p.k & Krapi Com, ndaj OE te rekomanduar janë pjesërisht të bazuara. Por oferta e OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com është administrativisht e pa përgjegjshme për mos plotësim siç duhet të FDT-së dhe mosplotësim te kritereve siç është potencuar me

lartë. Konsideroj që Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, ku për dëshmi te njëjta nuk ka vendosur ne mënyrë te njëjte për te gjithë ofertuesit. Konsideroj që Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, ku janë të obliguar të sigurojnë fondet publike dhe burimet publike në mënyrë ma ekonomike, duke pasur parasysh qëllimin dhe lëndën e Prokurimit pasi që OE i përgjegjshëm Construmax sh.p.k & NNSH TOP Projekt ka qenë më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë në vlerë prej 248,104.66 €.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e Grup i Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K.; N.N.SH. TOP PROJEKT të pranohet si e bazuar, ndërsa ankesa e Grup i Operatorëve Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.; Krapi Com SH.P.K., të pranohet si pjesërisht e bazuar, rrjedhimisht të anulohet Vendimi për Dhënie të Kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe ky Aktivitet të kthehet në **RIVLERËSIM**, me ç' rast Autoriteti Kontraktues gjatë rivlerësimit duhet të respektoj nenin 1, 6, 7, 59, 60, 67, 69, 72 te LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 30.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje të nderuar! AK Suharekë ka pranuar ekspertizën nr. 980-984/20, të datës 30.11.2020, me te cilën Autoriteti Kontraktues NUK PAJTOHET. AK kërkon që të mbetet në fuqi NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i Datës 13.11.2020. Përshkrim: AK me datë: 24/11/2020 ka njoftuar OSHP-në: Ju Njoftojm se përmes sistemit elektronik te prokurimit publik, është paraqit ankesa me datë 19.11.2020 nga OE CONSTRUMAX SH.P.K & NNSH " TOP PROJECT", për aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi -Faza e dytë , me numër prokurimi 624-20-4571-5-1-1. Me datë 01.09.2020 kemi publikuar Njoftimin për kontratë. Me datë 28.09.2020 Hapja e ofertave.n Me datë 02.11.2020 është publikuar NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES. Pas publikimit te njoftim vendimit, 2 nga OE kanë parashtrua për qasje, me te cilën ua kemi ofrua. Me datë 06.11.2020 është parashutuar kërkesa për Rishqyrtim e OE CONSTRUMAX SH.P.K & NNSH " TOP PROJECT, Po ashtu: Me datë 06.11.2020 është parashutuar kërkesa për Rishqyrtim nga Ada Cosulting Group Sh.P.K & Krapi Com Sh.P.K. Me datë 11.11.2020 AK Suhareke, Ka aprovua Pjesërisht Kërkesën e OE CONSTRUMAX SH.P.K & NNSH " TOP PROJECT, dhe Lënda është kthyer në Ri-Vlerësim,dhe është anulua njoftim vendimi i datës 02.11.2020, ndërsa ka Refuzua kërkesën e Ada Cosulting Group Sh.P.K & Krapi Com Sh.P.K. Pas Rivlerësimit, me datë 13.11.2020 është publikuar NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES. OE CONSTRUMAX SH.P.K

& NNSH " TOP PROJECT, ka kërkua qasje dhe e njëjta iu është ofrua. Me datë 19.11.2020 OE CONSTRUMAX SH.P.K & NNSH " TOP PROJECT, përmes platformës elektronike e-prokurimi ka paraqitur Ankesë në OSHP, pa e shfrytëzua mundësinë ligjore për paraqitje të kërkesës për Rishqyrtim pranë AK konform dispozitave ligjore për Prokurim Publik konkretisht Nenit 108/A të LPP-së, si dhe rregulloren për parashutimin e ankesave. Andaj kërkoj nga ju që Ankesa e OE në fjalë të hudhet poshtë si e pa ligjshme. Kundërshtimi i AK për përgjigjet e ekspertit për OE Ada Consulting Group Sh.P.K & Krapi Com Sh.P.K. AK- NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit për OE Ada Consulting Group Sh.P.K & Krapi Com Sh.P.K. për pretendimet te cilat i ka paraqitur si te bazuara. Pretendimi pjesërisht i bazuar për inxhinierin e Hidroteknikes, nuk qëndron, ngase i Njëjti Inxhinier plotëson kërkesën sipas DT, mbi përvojën e punës, Kualifikim dhe se ka kontrate me OE i shpallur për fitues nga AK, andaj te njëjtit nuk ka pasur nevojë për sqarime shtesë. Pretendimi tjetër i bazuar sipas ekspertit për nënshkrimin e listës se stafit dhe dokumenteve tjerë Nuk Qëndron. Ne dokumentacionin e OE i shpallur fitues, ne listën e kontratave shihet edhe Kontrata e punës e Astrit Gashi ku pozita e tij është Drejtor Ekzekutiv i Kompanisë andaj dhe ka te drejtën e nënshkrimit te kontratave dhe te dokumenteve tjera, andaj eksperti nuk ka vlerës këtë fakt. Pretendimi tjetër i bazuar sipas ekspertit OE i shpallur fitues, se OE I. Seferi nuk është pjese e ofertës se bashku me OE Fitues Nuk Qëndron. OE I. Seferi nuk është partner (koncerzium) me OE te shpallur fitues, dhe se përshkrimi i ekspertit bazuar ne interpretimin e krapit te pyetjet e shpeshta nr. 48, nuk është, për këtë rast sepse: Këtë Aktivitet AK nuk e ka te ndare ne LOT, dhe se OE i shpallur për fitues nuk ka koncerzium për këtë aktivitet, ashtu siç pretendon eksperti. Ndërsa lidhur me përgjigjet tjera te cilat eksperti për OE Ada Consulting Group Sh.P.K & Krapi Com Sh.P.K. te cilat pretendime i konsideron te pa bazuara pajtohemi. Prandaj bazuar ne te gjitha këto fakte dhe dëshmi te cekura me larte te cilat dëshmi gjinden ne platformën elektronike te e-prokurimit, Kërkon nga Paneli i OSHP-së, që të mbetet ne fuqi NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i Datës 13.11.2020, dhe te hedhen poshtë ankesat e parashtruara nga OE. Me respekt

Grupi i operatorëve Ekonomik: "Construmax"SH.P.K-Suharekë; N.N.SH "Top Projekt"SH.P.K-Suharekë, me datë 02.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar. Konzerciumi i jonë PAJTOHET me konstatimet e ekspertit për ekspertizën nr. 980-984/20 për projektin " Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi -Faza e dytë'' me nr. prok. 624-20-4571-5-1-1. Duke shpresuar në mirëkuptim, mirëpresim nga Paneli Shqyrtues të analizoj ankesën tone tek elaborimi nga Njoftimi për Kontratë gjatë vlerësimit deri në Vendimin e rekomandimit të OE për kontratë, ku kemi supozuar që AK ka përgatit këtë tender në kundërshtim me LPP-në për OE e rekomanduar për kontratë duke përshtat kritere vetëm për të ku kemi dorëzuar dëshmitë me ankesë, dhe gjatë vlerësimit në kundërshtim me

LPP-në nga zyra e Prokurimit të Suharekës janë kontaktuar bashkëpunëtorët e prezantuar në dokumentacion pa u informuar ne si kompani, andaj besojmë që janë shkelje serioze të ligjeve të LPP-së që do të mirëpresim marrje masave ndaj AK, që të mos përsëriten nga AK në të ardhmen. Me respekt.

Grupi i operatorëve Ekonomik: "Ada Consulting Group" SH.P.K; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë, me datë 03.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZËN Nr. 984/20 TË DT. 30.11.2020

Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr. 984/20 të dt. 30.11.2020 dhe ju informojmë se nuk pajtohemi me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Pajtohemi me konstatimet nr. 5, 6, 8, dhe 10 të ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet tona ankimore. Nuk pajtohemi me konstatimin nr. l të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor është pjesërisht i bazuar në lidhje me listat e projekteve të prezantuara nga lideri i grupit, sepse vetë eksperti ka konstatuar se lista e projekteve të prezantuara e tejkalon vlerën e kërkuar, mirëpo nuk janë dorëzuar referencat apo procesverbalet e pranimit teknik dhe se AK-ja ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së. Pra përderisa ne e kemi cekur se AK-ja ka mundur të kërkoj sqarime në lidhje me referencat apo procesverbalet e pranimit teknik, eksperti shqyrtues është dashur ta cilësoj pretendimin tonë ankimor si të bazuar. Nuk pajtohemi me konstatimin nr. 2 të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor në lidhje me inxhinierin e infrastrukturës rrugore është i pa bazuar dhe kinse në CV dhe as në referenca nuk ka dëshmi që inxhinieri i lartcekur e përmbush kërkesën në lidhje me përvojën e kërkuar. Ju sqarojmë se eksperti shqyrtues nuk e ka marrë fare parasysh dëshminë e trustit që e kemi prezantuar si dëshmi, i cili e tregon shumë qartë përvojën e inxhinierit të prezantuar nga ne. Andaj ky konstatim i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar.

Nuk pajtohemi me konstatimin nr. 3 të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor në lidhje me kamionin me kran i tipit Volvo FL 108x2 është i pa bazuar, sepse nuk e ka gjatësinë prej 25 m. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk qëndron për faktin se ne e kemi sqaruar në detaje gjatësinë e kamionit-kranit, ku shihet qartë se kamioni me kran i ofruar nga ne është 25.8 metra pasi që siç e dimë minimumi i kërkuar ka qenë 25 metra, andaj ne jemi të habitur se si eksperti shqyrtues ka konstatuar se kamioni i ofruar nga ne është 20.4 m. Nga ky konstatim i ekspertit shqyrtues po vërehet se eksperti nuk e ka analizuar në tërësi vizatimin e kranit të detajizuar për leximin e gjatësisë së kranit, mirëpo vetëm e ka përshkruar arsyen e njëjtë sikurse autoriteti kontraktues edhe pse ne e kemi sqaruar në detaje pretendimin tonë se kamioni me kran e përmbush kërkesën e AK.

Nuk pajtohemi me konstatimin nr.4 të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se CV e inxhinierit të infrastrukturës të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë e përmbush kërkesën në lidhje me përvojën e kërkuar. Ne jemi të habitur me këto konstatime të ekspertit shqyrtues për faktin se

ka përdorur standarde të dyfishta në ekspertizën e tij, ku ne edhe pse e kemi prezantuar CV dhe referencat ndërsa e kemi prezantuar edhe trustin të cilin eksperti nuk e ka analizuar fare, e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor të pa bazuar. Ndërsa tani duke u bazuar vetëm në CV edhe pse nuk janë ofruar referencat konstaton se inxhinieri i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë e përmbush kërkesën në lidhje me përvojën. Me këtë veprim të ekspertit po kuptohet se i njëjti ka bërë konstatime të njëanshme. Nuk pajtohemi me konstatimin nr.7 të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor është pjesërisht i bazuar, në lidhje me inxhinierin e Hidroteknikës Qamil Shala i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë pasi që ka paqartësi lidhur me referencën nga Diarko dhe mos përputhje me CV, andaj AK-ja ka mundur të kërkoj sqarime shtesë. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues është i paqëndrueshëm dhe i pa vërtetuar drejtë sepse është fakt që ekziston mospërputhje mes CV-së dhe referencës të lëshuar nga Diarko.

Nuk pajtohemi me konstatimin nr.9 të ekspertit shqyrtues në lidhje me validitetin e regjistrimit të kamionit ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor është i pa bazuar dhe ku ka arsyetuar se nuk ka qenë kërkesë e FDT-së. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar dhe njëkohësisht absurd, sepse si ka mundësi që një mjet i komunikacionit në këtë rast kamioni të qarkullojë përderisa nuk posedon regjistrim me afat. Ndërsa sa i përket pretendimeve të OE ankues Construmax &Top Projekt në lidhje me ofertën tonë të cilat eksperti shqyrtues i ka cilësuar si të bazuara, ku pretendim ka qenë se kinse ne kemi ndërhyrë në paramasë tek pozicione A.17, A.24 dhe B.20 nuk qëndron për faktin se në lidhje me pozicionin A. 17 ju sqarojmë se në rubrikën ku kemi pasur ta vendosim çmimin, AK-së i ka mbetur një çmim gabimisht, ndërsa ne po në atë rubrikë e kemi vendosur çmimin tonë, prandaj nuk ka ndërhyrje në paramasë tek sasitë apo njësitë.

Sa i përket pozicioneve A.24 dhe B.20 ju sqarojmë se në këto pozicione nuk kemi të bëjmë me ndonjë përshkrim të punëve që do të kryhen, por në këto pozicione është dashur vetëm të përshkruhen çmimet prej disa pozicioneve që kanë qenë më lartë të vendosura çmimet. Prandaj në këto pozicione ne vetëm kemi përshkruar çmimet që është dashur të përshkruhen ashtu siç është cekur te pozicioni ku e kemi përshkruar çmimin, andaj nuk ekziston asnjë ndërhyrje në paramasë siç ka pretenduar OE ankues dhe eksperti shqyrtues.

Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria e jonë dhe papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Me respekt.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të

prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Përgjigje në pretendimet ankimore të oe ankues : "Construmax"SH.P.K-Suharekë; N.N.SH "Top Projekt"-Suharekë,

Lidhur me pretendimin e grupit te Operatoreve ekonomik Construmax & Top Projekt që e plotëson kriterin lidhur me pune e kryera te natyrës se ngjashme ne tre vitet e fundit 3.9 milion euro, ku lideri i grupit duhet te ketë 60% te vlerës. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që lideri i grupit jo vetëm që e përmbush 60% e kërkuar mirëpo edhe e tejkalon, ku ka ofruar dëshmi të mjaftueshme me vërtetim nga banka në vlerë prej 4,409,392.558 €, me referenca e procesverbale të punimeve të kryera në vlerë 3,662,111.42 €. Disa projekte tjera janë në listën e projekteve si të përfunduara me te dhëna te pranimit final, e që konform nenin 72 AK mund te kërkoj sqarime shtesë. Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt është eliminuar pa arsye lidhur me para kontratën e inxhinierit të elektroteknikes, i cili në CV e tij është prezantuar që ka marrëdhënie pune edhe në KEDS dhe ka kontratë me OE me orar të plotë. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që OE konform kriterit të dosjes së tenderit ku është kërkuar kontratë e punës ose marrëveshje për projektin „para kontrata" ka ofruar Para kontratën me Inxhinieri e elektroteknikes z. Skender Nitaj për këtë projekt. Sikur OE ankues te kishte ofruar kontrate me orar te plote do ishte e bazuar arsye e eliminimit nga AK, ndërsa ne këtë rast OE ankues e ka ofruar para kontratën me z. Skender Nitaj ku vetëm nëse e fiton kontratën do te angazhohet ne ekzekutim ne te ardhmen me orar te plote. Çështja e para kontratave te prezantuara nga OE ankues vlen edhe për inxhinieret tjerë te prezantuar nga OE, e te cilët aktualisht janë ne marrëdhënie pune tjera, por para kontratat kane te bëjnë vetëm me këtë projekt dhe vetëm nëse shpërblehet me kontratën ne fjale do te angazhohen ne implementim te punëve me orar te plote. OE ankues ka prezantuar kontratë standarde për bashkëpunim për projekte të caktuar, si dhe ka bashkangjitur CV, diplomën e noterizuar si dhe një deklaratë të nënshkruar nga vetë inxhinieri i cili ka deklaruar që edhe nëse është i punësuar në ndonjë vend tjetër, është i gatshëm të ndërpres punimet dhe të shërbej në Construmax shpk për

këtë projekt. Po ashtu OE ankues ka ofruar edhe dëshmi listën e pagave në ATK dhe fletëpagesën nga banka për pagat Procredit BANK, ku ky inxhinier është si i punësuar nga muaji shtator në Consturmax dhe ju është paguar paga përmes bankës. OE ankues ka paraqit edhe listën e stafit shtesë qe mund te angazhohen për këtë projekt.

Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt se është eliminuar pa arsye lidhur me kontratën e inxhinierit të infrastrukturës i cili në CV e tij është prezantuar që ka marrëdhënie pune edhe me Komunën e Prishtinës dhe ka kontratë me OE me orar të plot. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që OE konform kriterit te dosjes se tenderit ku është kërkuar kontratë e punës ose marrëveshje për projektin „para kontrata'' ka ofruar Para kontratën me Inxhinieri e Infrastrukturës z. Besim Qelaj për këtë projekt. Sikur OE ankues te kishte ofruar kontrate me orar te plote do ishte e bazuar arsyeja e eliminimit nga AK, ndërsa ne këtë rast OE ankues e ka ofruar para kontratën me z. Besim Qelaj ku vetëm nëse e fiton kontratën do te angazhohet ne ekzekutim ne te ardhmen me orar te plote. Çështja e para kontratave te prezantuara nga OE ankues vlen edhe për inxhinieret tjerë te prezantuar nga OE, e te cilët aktualisht janë ne marrëdhënie pune tjera, por para kontratat kane te bëjnë vetëm me këtë projekt dhe vetëm nëse shpërblehet me kontratën ne fjale do te angazhohen ne implementim te punëve me orar te plote. OE ankues ka prezantuar kontratë standarde për bashkëpunim për projekte të caktuar, si dhe ka bashkangjitur CV, diplomën e noterizuar si dhe një deklaratë të nënshkruar nga vetë inxhinieri i cili ka deklaruar që edhe nëse është i punësuar në ndonjë vend tjetër, është i gatshëm të ndërpres punimet dhe të shërbej në Construmax shpk për këtë projekt. Po ashtu OE me ankese ka ofruar edhe dëshmi listën e pagave në ATK dhe fletëpagesën nga banka për pagat, ku ky inxhinier është si i punësuar nga muaji shtator në Consturmax dhe ju është paguar paga përmes bankës PCB.
Po ashtu OE ankues ka paraqit edhe listën e stafit shtesë qe mund te angazhohen për këtë projekt., dhe sqaron që punimet elektrike janë punime që zhvillohen sipas planit dinamik dhe mund të përcillen edhe nga një inxhinier me punë sekondare.

Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt është eliminuar pa arsye, lidhur me eliminimi e këtij OE që i mungon Ekskavatori me tonazh 1.2 deri në 1.7 ton. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që ka ofruar marrëveshje mbi dhënien me qira me Horn & Co. Kosova sh.p.k, të dy mini ekskavatorëve: Mini ekskavator 1.751 ton, Marka Volovo, Tipi EC, nr i shasisë VCE0C18CV00002588 dhe Mini ekskavator 1.860 ton, Marka Kubota, Tipi : KX018-04-SN, nr. i shasisë ËKFRGF1100X05644 Po ashtu ka prezantuar edhe DUD-at doganor dhe katalogun e prodhuesit për këta ekskavator. Ku Eksperti Shqyrtues ka konstatuar

se në DUD-in doganor R 11465 I datës 21/08/2015 është pesha e ekskavatorit 1.751 ton dhe e plotëson kërkesën e dosjes së tenderi duke pasur parasysh edhe aksesorët e tij.

Ne ofertën e OE ankues ekziston katalogu – specifikacioni i ekskavatorit te brendit "Kubota" ne te cilin janë te specifikuara ne mënyrë te qartë te gjithë parametrat e ekskavatorit te ofruar.

AK janë referuar vetëm ne një parametër 1860 kg, e cila është pesha ne total e ekskavatorit e ku përfshihen edhe shume pjesë "aksesor" rezervë si p.sh: Lugët e disa dimensioneve, shkallet e ngarkimet, pllatot e ngarkimit, zinxhirët etj. Ndërsa pesha reale e vetëm ekskavatorit është 1620kg dhe është Brenda parametrave te kërkuara nga AK ne NJK dhe DT. Pavarësisht nga sqarimet e lartcekura, edhe sikur te qëndronte arsyeja e cekur nga AK, kjo mund te konsiderohej si devijim i vogël bazuar ne Nenin 59 te LPP-së, paragrafi nr. 4 theksohet se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Për dëshmi parametrat e ekskavatorit sipas skicës me lart.

Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt se është eliminuar pa arsye, lidhur me pozicionin e parë në paramasë si pozicion manipulativ dhe qe nuk mund të arsyetohet me asnjë rregull e as standard inxhinierik. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues nuk e ka sqaruar saktë pse është çmim manipulativ, dhe nuk ka dërguar ndonjë formular për sqarime të çmimit Jo-normalisht të ulët. OE ankues në pozicionin e parë në paramasë ka vendosur çmimin njësi në vlerë prej 217,000.00€ ku përshkrimi ka qenë „Pastrimi i terrenit dhe shenjëzimi i vendit për ndërtimin e objektit", të njëjtin çmim e ka shumëzuar dhe ka mbledhur në rekapitullim. Sa i përket pretendimit që OE Construmax & Top Projekt është eliminuar pa arsye lidhur me kontratën e inxhinierit të Arkitekturës e cila ka marrëdhënie pune edhe në Ministri dhe ka kontratë me OE me orar të plotë. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi që OE ka ofruar Kontratë Pune me inxhinieren e Arkitekturës, dhe të njëjtën e ka edhe në lista të pagave, si dhe ka bashkangjitur CV, diplomën e noterizuar, mirëpo sipas sqarimeve te ekspertit shqyrtues që janë përdor kritere të dyfishta gjate procesit te vlerësimit, pasi që edhe OE i shpallur fitues në CV e stafit dëshmohet që janë duke punuar në kompani tjera dhe nuk janë eliminuar. Sa i përket inxh. te Arkitekturës, vlen te theksohet znj. Arzie Zeneli

figuron ne Listën e punëtoreve ne ATK tek OE ankues dhe ku dëshmohet se znj. Zeneli nuk është e angazhuar si staf primar por sekondar. Vlen të theksohet se lideri i konzerciumit OE Construmax ne kuadër të stafit profesional për angazhim ne këtë projekt i ka edhe dy inxhinier të arkitekturës z. Nexhat Jashari me përvojë 20 vite dhe znj. Krenare Shkodra me përvojë 7 vite. Andaj kriterin e inxhinierit te arkitekturës mund ta plotësoj edhe vetëm lideri nëse AK e sheh te nevojshme me sqarime shtese bazuar ne nenin 72 te LPP-se, pasi qe e ka të bashkangjitur me ofertë Listën e stafit te inxhiniereve bashkëpunëtor që mund të kyçën në projektin „ Ndërtimi i Shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi- Faza e dytë'' Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE e rekomanduar i cili që nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme për Inxhinierin e Infrastrukturës që ka përvojë 3 vjeçare. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar, pasi që në CV e tij ka dëshmi që ka përvojë 3 vjet si inxhinier i infrastrukturës. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt nr. 9, 10, 11,12 që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE Euroing pasi që nuk ka prezantuar dëshmi që inxhinieret do të punojnë në Euroing për këtë projekt pasi që në CV e tyre ceket që vazhdoj në kompani tjera. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se këto pretendime të OE ankues janë pjesërisht te bazuara, pasi që OE i rekomanduar ka ofruar Kontratë mbi Vepër, CV, Diplomë të Noterizuar dhe Referencë, ndërkohë qe Inxhinieret ne fjale janë ne marrëdhënie pune ne kompani tjera. Kjo është situate e njëjtë me disa nga inxhinieret e prezantuar edhe nga konzerciumi ankues Construmax & Top Projekt, andaj duhet te vleje parimi i njëjtë, ku duhet te pranohen para kontratat për projektin ne fjale qe nëse OE e fiton kontratën ti angazhoj inxhinieret gjate implementimit te punëve. AK duhet ti trajtoj ne mënyrë te barabarte operatoret ekonomik konform nenit 7 te LPP-se dhe për situatën e njëjtë me para kontrata nuk duhet qe një OE ta eliminoj ndërsa një OE ta shpalli fitues. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt, rreth ofertës financiare te OE te rekomanduar dhe që Autoriteti Kontraktues nuk i ka korrigjuar gabimet aritmetike që kalojnë 21% të vlerës së ofertuar. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi që OE i rekomanduar ka vendosur në kolonën e paramasës tek „Çmim njësi (€)'' ka vendosur çmime njësi 40 %, 3.5 %, 3.5%. Nuk ekziston njësi monetare ne përqindje (%), dhe në dosje të tenderit tek Seksioni I. Informacione për tenderuesit, paragrafi 20 specifikon se : 20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit -20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro **(€).** Çmimi i ofertuar lejohet qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës.

Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit (pasi qe Eksperti është Ing me profesion) konstaton se OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar siç duhet FDT - Formularin e Dorëzimit te Tenderit, që është dokumenti kryesor i ofertës, dhe ku Pjesa II - Përshkrimi i Çmimeve është

pjese e FDT-se. Për 3 pozicione të paramasës OE i rekomanduar nuk ka ofruar çmim në Euro siç kërkohet në Dosje te tenderit dhe çmimet e ofruar në përqindje janë të papranueshme. Në bazë RRUOPP-së neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrative, andaj OE i rekomanduar Euroing nuk e ka plotësuar këtë kriter. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE e rekomanduar pasi që ky OE ka ndërhyrë në paramasë, duke i ndryshuar sasitë e 3 pozicioneve të paramasës së publikuar nga AK.

Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi që OE i rekomanduar Euroing, sasitë e publikuara në e-prokurim i ka ndryshuar në ofertën e dorëzuar: Pozicionet të cilët janë ndryshuar nga OE Euroing janë: Pos A.17 nga sasia e tenderuar 4,960.00 është ndryshuar në 3,070.60- sasia e ofertës financiare Pos A.24 nga sasia e tenderuar 0 është ndryshuar në 38,610.09- sasia e ofertës financiare Pos B.20 nga sasia e tenderuar 0 është ndryshuar në 79,109.00 - sasia e ofertës financiare Në rast që OE ka pasur paqartësi lidhur me sasitë e paramasës se tenderuar ka mundur të kërkoj sqarime shtesë përmes "Aneksi 5 - Kërkesa për informacione shtesë" , pasi që paramasa është pjese e FDT dhe nuk mund të ndryshohet nga OE. Në bazë RRUOPP neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrative, andaj OE i rekomanduar Euroing nuk e ka plotësuar këtë kriter. Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që OE tjetër Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që janë të papërgjegjshëm pasi që i mungon qarkullimi me kontrata 60% liderit të grupit, Paneli shqyrtues sqaron se OE Ada Consulting Group e ka prezantuar qarkullimin bankar 17,333,781.48€ dhe ka prezantuar edhe listën e projekteve, ku Autoriteti Kontraktues konform nenin 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë për referencat për punimet e kryera sipas listës së projekteve të prezantuara.

Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që janë të papërgjegjshëm pasi që inxhinieri i Infrastrukturës rrugore i prezantuar nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është pjeserisht i bazuar, pasi që OE Ada Consulting Group ka prezantuar inxhinierin e Infrastrukturës Rrugore që ka diploma në vitin 2015, AK mund te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projekt që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që janë të papërgjegjshëm për arsye që nuk ka ofruar kamion me kran sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar për arsye që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k, ka

dorëzuar me ofertë një marrëveshje për shfrytëzim të pajisjeve me kompaninë A CON sh.p.k dhe ne librezën e Kamionit me Vinç 2 dyer me regjistrim 01-625-MS ku nuk ceket gjatësia e kranit, mirëpo në dy skicat e gjatësisë së kranit PK 66000E gjatësia ma e madhe është 20.4 m' ndërsa tjetra skicë e PJ 115D PK 66000E është 13.6m, ndërsa kërkesa në dosje të tenderit ka qenë mbi 25m. Bazuar në skicat e ofruara ky kamion nuk e plotëson gjetësin e kranit ashtu siç është kërkuar ne DT prej 25m. Mirëpo gjate rivlerësimit AK mund te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që Autoriteti Kontraktues nuk i ka eliminuar OE Ada Consulting Group shpk & Krapi Com sh.p.k pasi që ky OE ka ndërhyrë në paramasë. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k sasitë e publikuar në e-prokurim ka ndryshuar në ofertën e dorëzuar. Në rast që OE ka pasur pa qartësi lidhur me sasitë e publikuar ka mundur të kërkoj sqarime shtesë përmes "Aneksi 5 Kërkesa për informacione shtesë" - pasi që paramasa është pjese e FDT dhe nuk mund të ndryshohet nga OE. Në bazë te RRUOPP neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ.

Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k pasi që ky OE ka gabim aritmetik tek ngrohja qendrore që tejkalon vlerën 2%. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi që OE ka vendosur në kolonën tek „Çmim njësi (€)'' ka vendosur në pozicionin B.20 çmime 3.5%, ku nuk ekziston njësi monetare përqindje (%), dhe në dosje të tenderit tek Seksioni I. Informacione për tenderuesit, paragrafi 20: 20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit -20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro **(€).** Çmimi i ofertuar lejohet qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës.

Në bazë RRUOPP neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrativ, andaj OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k nuk e ka plotësuar këtë kriter. Bazuar në dosje të tenderit, Paneli shqyrtues konform sqarimeve te Ekspertit Shqyrtues konsideron që çmimi njësi është në Euro jo në % dhe shuma kalkuluese e njësive me çmimet e ofertuar tejkalon 2% e gabimit aritmetik të lejuar me LPP-në dhe ky gabim aritmetik është 66,920.00 * 3.5 = 234,220.00 €, ndërsa shuma në ofertë është 2,342.20 € d.m.th. kemi gabim aritmetik mbi 2% krahasuar me totalin e ofertës. Në rast që OE ka pasur pa qartësi lidhur me plotësimin e çmimeve njësi ka mundur të kërkoj sqarime shtesë përmes ,"Aneksi 5 - Kërkesa për informacione shtesë" në dosje të tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE Construmax & Top Projek që OE „ISEFERI" nuk i plotëson as kushtet administrative për këtë tender. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi që OE „ISEFERI" nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit d.m.th. nuk e ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit, nuk plotëson qarkullimin e kërkuar, nuk i ka ofruar referencat e natyrës së ngjashme, nuk e plotëson stafin e kërkuar, nuk ka dëshmi për makineri, andaj konsiderojmë që ky OE nuk i ka plotësuar kriteret e tenderit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të oe ankues: "Ada Consulting Group "SH.P.K,; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë,

Sa i përket pretendimit OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që lideri i grupit nuk e plotësoni qarkullimi me kontrata 60%. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, pasi që kozorciumi OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k ka dorëzuar listat e projektit të ekzekutuara edhe lideri edhe partneri i konzorciumit, ku në lista vërehen projekte që kalojnë vlerën e kërkuar, mirëpo lideri i grupit nuk ka dorëzuar referenca apo procesverbale të pranimit teknik ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. AK ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga OE bazuar në nenin 72 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group shpk & Krapi Com sh.p.k që arsyeja e dyte që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që Inxhinieri i Infrastrukturës rrugore nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, pasi që kozorciumi i OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k ka dorëzuar diplomën, cv dhe referencat per inxhinierin dhe gjate rivlerësimit AK mund te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit te OE ankues Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që arsyeja e tretë që është eliminuar padrejtësisht është që kamioni me kran i tipit Volvo FL 108x2 me numër të targave 01-825-MS nuk e ka gjatësinë prej 25m sipas njësisë së kërkesës por është 20.4m. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe gjate rivlerësimit AK mund te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com sh.p.k që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm paneli shqyrtues sqaron se pretendimet qe janë te njëjta ndaj OE te rekomanduar per kontrate, janë sqaruar me larte.

Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapi Com që kamioni i prezantuar nga OE për kontratë me targa 639-KS-229, i cili është me regjistrim të skaduar dhe që nuk plotëson kërkesën në lidhje me mjetet e kërkuara. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i pa bazuar, pasi që validiteti i Regjistrimi te kamionit nuk ka qenë kërkesë e NJK dhe DT.

Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.pk. & Krapi Com që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshja për shfrytëzim të mjeteve të cilën e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë është e lidhur me një OE i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të Prokurimit pra me kompaninë ISEFERI sh.p.k, si dhe mos nënshkrimi nga pronari mirëpo nga një person i pa autorizuar. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi që OE ISEFERI është ofertues në këtë tender dhe nuk ka te drejt të jetë pjesë e ndonjë oferte tjetër për të njëjtin tender. Marrëveshja për shfrytëzim të mjeteve është pjese e tenderit, dhe kompania ISEFERI sh.p.k me rastin e lidhjes se marrëveshjes me OE te rekomanduar është bërë pjesë e ofertës se tij. Ne lidhje me këtë çështje merret për bazë interpretimi i dhënë nga KRPP, për rastin e ngjashëm ku parimi ligjor është i njëjtë - Pyetjet e shpeshta, Pyetja nr. 48. Gjithashtu, nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet te prokurimit të ndarë në LOT-e, në njërin LOT konkurron si i vetëm, ndërsa ne një Lot tjetër ne grup, kjo kompani nuk mund te dorëzoj deklaratën qe konfirmon se ai anëtar nuk është duke marre pjese ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe per çdo paqartësi te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe

burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 /AK/ - "KK-Suharekë",

1x1 / OE/ - "Construmax"SH.P.K-Suharekë; N.N.SH "Top Projekt"SH.P.K-Suharekë,

1x1 /OE/ - "Ada Consulting Group" SH.P.K; "Krapi Com"SH.P.K-Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së